

VENDIM
Nr.713, datë 29.10.2004

**PËR MIRATIMIN E SHPENZIMEVE OPERATIVE, PËR VITIN 2005, TË ENTIT
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT E
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e shpenzimeve operative, për vitin 2005, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe i Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Enti Rregullator i Ujit

Projektplani i shpenzimeve për vitin 2005

PASQYRA NR.1

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Planifikuar për vitin 2005
I	Fondi i pagave	14 700
II	Sigurime shoqërore	4200
III	Shërbime e furniturë	4850
IV	TVSH e taksa doganore	500
V	Investime	700
	Totali	24 950